

# FLEXCOAT

## Bojë akrilike hidroizoluese shumë elastike

### Përshkrimi

FLEXCOAT është një bojë e cilësisë së lartë e tretshme në ujë që bazohet në rrëshirat akrilike elastomrike dhe që ofron:

- Papërshkueshmëri totale nga uji, mbrojtje të mureve nga shiu.
- Përshkueshmëri për avullin, duke e lejuar strukturën të "marrë frymë".
- Elasticitet të lartë, kapacitet për të mbuluar sipërfaqet e plasaritjeve (mbushje e plasaritjeve).
- Ngjitje të shkëlqyer dhe mbulim të sipërfaqes.
- Rezistencë ndaj larjes.

### Fushat e përdorimit

FLEXCOAT rekomandohet për lyerjen e fasadave për shkak të qëndrueshmërisë së lartë ndaj kushteve të motit. Është e përshtatshme për përdorim në ambiente të brendshme dhe të jashtme, sipërfaqe të reja dhe të vjetra, mbi të gjitha llojet e materialeve të ndërtimit si betoni i ekspozuar, suvaja, tullat, përzierje asbest-çimento (eternit), pllaka gipsi etj. Në ambiente të brendshme, rekomandohet për zona ku kërkohet pastrim i shpeshtë dhe fortësi e lartë, si kuzhinat e gatimit, banjat, garazhet, spitalet, hapësirat industriale etj. Mund të përdoret gjithashtu mbi shtresat bituminoze, mbi membranat bituminoze dhe poliuretane, për mbrojtje nga drita e diellit.

### Të dhënat teknike

|                      |   |
|----------------------|---|
| Ngjyrat:<br>zgjedhje | e bardhë dhe 20 me                      |
| Viskoziteti:         | 7100 ± 700 mPa.s<br>(Brookfield, +23°C) |
| Densiteti:           | 1,46 kg/litër                           |
| pH:                  | 9,2 ± 0,3 at +20°C                      |

Rezistenca ndaj larjes:  
(DIN 53778-2)

>20.000 cikle

Koha e tharjes: 1 orë (në kontakt)

Riveshje: 4 orë

Pastrimi i veglave:  
Pas përdorimit, veglat duhet të pastrohen me menjëherë me ujë.

### Udhëzimet e përdorimit

#### 1. Nënshtrësja

Sipërfaqja duhet të jetë e pastër, e thatë dhe pa graso, pluhur dhe materiale të lira mbi të.

- Të çarat ose bashkimet duhet të mbushen me izolues ISOMASTIC-A.
- Problemet mbi suva duhet të riparohen me llaç DUROCRET të modifikuar me polimer, dhe mbi betonin e ekspozuar me stuko PLANFIX ose PLANFIX-FINE të modifikuar me polimer.
- Riparimet e suvasë bëhen me llaç të gatshëm UNICRET ose UNICRET-FAST.

Pas kësaj duhet të vijojë lyerja me FLEX-PRIMER akrilik, me konsum 100-200 g/m<sup>2</sup>, në varësi të aftësisë thithëse të sipërfaqes. FLEX-PRIMER rekomandohet në mënyrë të veçantë për suvanë e lirë ose që shkërmoqet.

#### 2. Përdorimi

FLEXCOAT përdoret siç është ose e holluar me ujë deri në 5%. Ajo duhet të trazohet mirë plotësisht përpara përdorimit. Aplikohet me rul, furçë ose spërkatje pa ajër, në dy duar. Dora e dytë bëhet pasi është tharë e para. Në rastet e plasaritjeve të rënda të izoluar, FLEXCOAT mund të përforcohet përgjatë plasaritjes me një shirit cope poliestre (30 g/m<sup>2</sup>), në 10 cm gjerësi. Në rastet e plasaritjeve të shumëfishta, FLEXCOAT mund të përforcohet plotësisht me të njëjtën cope poliestre, në 100 cm gjerësi.

# FLEXCOAT



## Mbulimi

FLEXCOAT mbulon 8-10 m<sup>2</sup>/litër për shtresë, në varësi të aftësisë thithëse të nënshtresës.

## Ambalazhimi

FLEXCOAT ofrohet në kova plastike 3 litër dhe 10 litër.

## Magazinimi

Afati i ruajtjes për përdorim në kova të izoluara dhe në ambiente pa ngrica është minimumi 24 muaj.

## Përbërësit organikë të avullueshëm (VOC)

Sipas Direktivës 2004/42/KE (Shtojca II, tabela A), përmbajtja maksimale e lejuar e VOC-së për produktin e nënkategorisë "c", lloji WB është 40g/l (2010) për produktin e gatshëm për përdorim.

Produkti i gatshëm për përdorim FLEXCOAT përmban maksimumi <40 g/l VOC.



2032

**ISOMAT S.A.**

17<sup>th</sup> km Thessaloniki – Ag. Athanasios  
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag Athanasios, Greece

15

2032-CPR-10.11

DoP No.: FLEXCOAT / 1423-03

**EN 1504-2**

Surface protection products

Coating

Permeability to CO<sub>2</sub>: Sd > 50m

Water vapor permeability: Class I (permeable)

Capillary absorption: w < 0.1 kg/m<sup>2</sup>·h<sup>0.5</sup>

Adhesion: ≥ 1.0 N/mm<sup>2</sup>

Artificial weathering: Passes

Dangerous substances comply with 5.3

## ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS AND MORTARS

**ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:**

17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,  
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,  
Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 722 475

[www.isomat.eu](http://www.isomat.eu) e-mail: [info@isomat.eu](mailto:info@isomat.eu)

Informacioni teknik dhe udhëzimet e dhëna në këtë fletë të dhënash bazohen në njohurinë dhe në përvojën e Departamentit të Kërkimit dhe të Zhvillimit të kompanisë sonë dhe në rezultatet e dala nga përdorimet afatgjata të produktit në praktikë. Rekomandimet dhe sugjerimet që i referohen përdorimit të produktit jepen pa garanci, meqenëse kushtet e terrereve gjatë përdorimeve të tij janë përtej mundësisë së kontrollit të kompanisë sonë. Si rrjedhojë, përdoruesi është përgjegjës për të konfirmuar se produkti i zgjedhur është i përshtatshëm për përdorimin e parashikuar. Botimi aktual i kësaj flete të dhënash teknike anulon automatikisht çdo botim të kaluar që lidhet me të njëjtin produkt.

